

Ndërtimi i Një Ekosistemi Efektiv Kundër Pastrimit të Parave

Nga menaxhimi i riskut reaktiv drejt atij proaktiv

Pastrimi i parave ka pasojë shkatërruese për ekonominë dhe shoqërinë tonë. Është thelbësore të sigurohet që lufta kundër këtij fenomeni të jetë efektive. Publikimi [Ndërtimi i një ekosistemi efektiv kundër pastrimit të parave](#) paraqet rekomandime për të zbatuar më mirë legjislacionin ekzistues kundër pastrimit të parave/ luftimit e financimit të terrorizmit. Kjo përputhet me propozimet e Komisionit Europian (KE) kundër Pastrimit të Parasë/Financimit të Terrorizmit për tu siguruar që mjedisi aktual legjislativ të funksionojë me efektivitet.

Çdo lojtar ka rolet dhe përgjegjësitë përkatëse në ekosistemin kundër Pastrimit të Parave. Është e rëndësishme që secili aktor të luajë pjesën e tij në mënyrën e duhur. Bashkëpunimi midis subjekteve të detyruara, mbikëqyrësve dhe politikbërësve është çelësi për të arritur zbutjen efektive të riskut nga Pastrimi i Parave.

Kush janë subjektet e detyruara?

Subjektet e detyruara (SD) janë grupuar në subjekte financiare të tilla si bankat dhe shoqëritë e sigurimit dhe jo-financiare siç janë audituesit, kontabilistët e jashtëm dhe konsulentët fiskalë, noterët, juristët dhe profesionistët e tjerë ligjorë, trustet ose kompanitë e ofrimit të shërbimeve, agjentët e pasurive të paluajtshme, ofruesit e shërbimeve të lojrave të fatit. Atyre iu kërkohet nga legjislacioni i BE-së për Luftën Kundër Pastrimit të Parasë të kenë politika, kontrolle dhe procedura të dizenuara për të vlerësuar dhe zbutur rreziqet e pastrimit të parasë/financimit të terrorizmit. Ata gjithashtu priten të marrin në konsideratë faktorët e rrezikut që lidhen psh. klientët e tyre, produktet, shërbimet, transaksionet, zona gjeografike.

Për të siguruar një luftë më efektive kundër pastrimit të parasë dhe financimit të terrorizmit, ne shqyrtojmë rolet e i) **SD-ve jo-financiare duke përfshirë kontabilistët** ii) **mbikëqyrësit dhe politikbërësit** dhe propozojmë rekomandime për përmirësimin e rolit të tyre në luftën kundër pastrimit të parasë. Këto rekomandime duhet të konsiderohen në mënyrë proporcionale dhe në përputhje me madhësinë, mundësitë dhe profilin e riskut të njësisë ekonomike.

NGA MENAXHIMI REAKTIV I RISKUT KUNDËR PASTRIMIT TË PARASË NË ATË PROAKTIV DHE PARANDALUES

Ne propozojmë tre veprime kryesore për subjektet e detyruara për të kaluar nga një qëndrim reaktiv në proaktiv:



1. Forcimin e Mëtejshëm të Sistemeve të Bazuara në Risk dhe Kontrolleve

- Zbatimi i kontrolleve në përpjestim me rreziqet – kontrollet duhet të jenë më të shtuara kur një biznes vlerëson aktivitetet e tij me rrezik më të lartë.
- Vlerësimi i nevojës për kujdes të thjeshtuar ose të shtuar për klientin (CDD) – qëllimi i CDD nuk është thjesht të përcaktojë ekzistencën e personit ose njësisë ekonomike, po të kuptojë rreziqet që klienti mund të paraqesë.
- Menaxhimi i oreksit për risk në përputhje me tolerancën ndaj riskut – SD duhet të vlerësojnë nëse ata kanë kapacitet për të përballuar rreziqet e identifikuar para se të pranojnë një klient.



2. Njohje më e mirë dhe zbutja e rreziqeve të Pastrimit të Parave

- Të sigurojë tranjime efektive të stafit në lidhje me lufën kundër Pastrimit të Parave që duhet të mundësojnë kuptimin e kërkesave rregullatore dhe rëndësinë e tyre për bizneset subjekte të detyruara (SD)
- Të kuptojë rreziqet specifike të sektorit – secili sektor mund të paraqesë rreziqe të ndryshme dhe flamujt e kuq mund të ndryshojnë.
- Të promovojë bashkëpunimin –SD mund të përmirësojnë ndërgjësimin e tyre për rreziqet nëpërmjet diskutimeve me aktorë të tjerë të ekosistemit Kundër Pastrimit të Parave.



3. Shfrytëzimi i teknologjisë për efikasitet

- Të përdorë teknologjinë për klientët e rinj dhe procedurat e njohjes së klientit (PNK).
- Integrimi i mjeteve dixhitale në punët e përditshme

Forcimi i Luftës Kundër Pastrimit të Parave përmes Qeverisjes së Përmirësuar

Lufta kundër pastrimit të parave duhet të integrohet në strukturat e qeverisjes dhe menaxhimit të riskut së SD-ve. Kjo gjithashtu mund të lejojë që një SD të jetë proaktive ndaj rreziqeve të pastrimit të parave dhe të sigurojë monitorim, raportim dhe mbikëqyrje të vazhdueshme. Ne propozojmë rekomandime për bordet e kompanive dhe drejtimin për t'i ndihmuar ata të kuptojnë më mirë ekspozimin ndaj rrezikut të pastrimit të parasë dhe dobësitë kryesore.

- Krijoni një proces të përshkallëzuar për të lejuar punonjësit të raportojnë mosrespektimin e rregullores kundër pastrimit të parave.
- Siguroni menaxhim proporcional të rrezikut të pastrimit të parave.



Rekomandime për Drejtimin

- Linja e parë e mbrojtjes: sigurohuni që ata që janë të përfshirë në operacionet e biznesit të kuptojnë rreziqet e tyre lidhur me pastrimin e parave/financimin e terrorizmit dhe detyrimet e tyre për të respektuar menaxhimin e këtyre rreziqeve.
- Linja e dytë e mbrojtjes: vlerësoni rregullisht nëse proceset e kontrollit janë efikase dhe efektive për të menaxhimin e rreziqeve për pastrimin e parave.
- Linja e tretë e mbrojtjes: sigurohuni që qëllimi dhe metodologjia e auditimit janë të përshtatshme për profilin e rrezikut dhe që frekuenca e auditimeve të tilla bazohet gjithashtu në rrezik

Përforconi Kornizën Rregullatore dhe Mbikëqyrëse



Rekomandime për mbikëqyrësit dhe politikëbërësit

Mbikëqyrja dhe rregullatorët duhet të modernizohen gjithashtu për të siguruar funksionimin e duhur të ekosistemit në luftën kundër pastrimit të parasë. Për ta përforcuar më tej kornizën rregullatore dhe mbikëqyrëse, në rekomandojmë që mbikëqyrësit dhe politikëbërësit të:

Rritje e bashkëpunimit midis shteteve anëtare

Ndarja e informacionit dhe njohurive nëpërmjet autoriteteve kombëtare të mbikëqyrjes është thelbësore që sistemi kundër pastrimit të parave të jetë efektiv. Shtetet anëtare duhet gjithashtu të sigurojnë që SD të kenë qasje të mjaftueshme në informacion. Kjo mund të arrihet përmes ndarjes së të dhënave dhe sistemeve të ndërvëprimit.

Lehtësimi i bashkëpunimit midis sektorit privat dhe atij publik

Aktorët shtetërorë duhet të kapërcejnë 'tabunë' e bashkëpunimit me sektorin privat për të luftuar krimin financiar. Bashkëpunimi i zgjeruar midis SD dhe autoriteteve mund të informojë dhe përmirësojë më mirë kuptimin e kërcënimeve të përbashkëta.

Kjo praktikë nuk është e mirë-vendosur për të gjitha SD-të, veçanërisht në sektorin jo-financiar. Këto partneritete duhet të jenë ndër-sektoriale, duke përfshirë institucionet financiare si dhe organizata të tjera të sektorit privat dhe agjensitë e zbatimit të ligjit.

Rishikoni Ndërveprimin midis Luftës kundër Pastrimit të Parave dhe Rregullores së Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave (GDPR)

Ndikimi i GDPR në legjislacionin kundër pastrimit të parave duhet të rishikohet. Ekziston një konflikt i qenësishëm i interesit midis parandalimit të pastrimit të parave/financimit të terrorizmit dhe mbrojtjes së të dhënave të lidhura me GDPR. Rregullat kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit inkurajojnë që të mbledhin dhe analizojnë sa më shumë të dhëna të jetë e mundur për të identifikuar modelet dhe kriminelët, ndërsa GDPR synon të kufizojë përdorimin e të dhënave personale në shkallë të gjerë.

Konsideroni divirgjencat specifike të sektorit

Legjislacioni duhet të përshtatet më mirë për SD në sektorin jo-financiar. Rregullat duhet të pranojnë se ekzistojnë lloje të ndryshme të SD dhe të identifikojnë dhe të synojnë faktorët që duhet të marrin në konsideratë.



Rekomandime për Bordet e Kompanive

- Ndërtoni një kulturë të fortë kundër pastrimit të parave.